

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTI DETAR SARANDË**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Porti Detar Sarandë, , me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën nga deri 01.10.2012 deri më 30.05.2014, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 117 datë 15.09.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 607/9 datë 15.09.2014, dërguar Z. Sotir Devalla, Drejtor i Portit Detar, Sarandë, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

Nga Ministria e linjës, nuk janë nxjerrë aktet nënligjore që rregullojnë procedurat e licencimit në fushën e transportit detar, e përcaktuar kjo në ligjin nr.10081, datë 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, neni 52, “Aktet nënligjore”, si dhe VKM nr.538, datë 26.05.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, kreu XI, “Hapat për zbatimin e vendimit”, ***sa më sipër rekomandoj:***

**1-** Ministria e Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të nxjerrë aktet nënligjore që rregullojnë procedurat e licencimit në fushën e transportit detar, e përcaktuar kjo në ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, neni 52, “Aktet nënligjore”, si dhe VKM nr. 538, datë 26.05.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, kreu XI, “Hapat për zbatimin e vendimit”.

***Menjëherë***

Pasqyrat financiare, janë paraqitur për miratim përfundimtar dhe janë miratuar me vonesë, ***sa më sipër rekomandoj:***

**2-** Këshilli Mbikëqyrës të miratojë dhe shqyrtojë në afat pasqyrat vjetore financiare, në përputhje me afatet e përcaktuara në Udhëzimin e METE, nr. 318 datë 08.04.2009, “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, paragrafi IV, pika 7. .

***Vazhdimisht***

Miratimi i programit vjetor dhe tematikës së mbledhjeve, nuk është kryer me Vendim të këshillit mbikëqyrës. Mbledhjet e këshillit mbikëqyrës, nuk janë zhvilluar sipas njoftimeve dhe relacioneve të paraqitura nga Administratori, por njoftimet janë kryer 1 ose 3 ditë më parë se data e zhvillimit të mbledhjes. Në mbledhjet e këshillit mbikëqyrës, nuk janë kryer diskutime ose informacione nga Drejtori i Shoqërisë, mbi realizimin e detyrave të lëna nga një mbledhje e mëparshme, në kundërshtim me udhëzimin e METE-s, nr.318, datë 08.04.2009. Kryetari i këshillit mbikëqyrës nuk ka firmosur në emër të këshillit mbikëqyrës, kontratën “Për administrimin e shoqërisë” me drejtorinë e SHA “Porti Detar” Sarandë, ***sa më sipër rekomandoj:***

**3-** Këshilli Mbikëqyrës të inkurajojë paraqitjen, si dhe të miratojë e shqyrtojë brenda datës 15 tetor të çdo viti, programin ekonomik në përputhje me Udhëzimin e METE nr. 315, datë 08.04.2009, “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”, paragrafi III, pika 4: shqyrtimi dhe marrja e vendimit. .

***Vazhdimisht***

**4-** Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë, të marrin masat e nevojshme për të bërë analiza dhe vlerësime të hollësishme tekniko-ekonomiko-financiare, në mënyrë që të shmangen në maksimum ndryshimet në programin e zhvillimit, mangësitë e konstatuara në programimin e zërave siç edhe ka ndodhur gjatë viteve të mëparshme.

***Vazhdimisht***

**5-** Këshilli Mbikëqyrës, të referojë dhe të zbatojë me përpikëri bazën ligjore të veprimtarisë së tij, për të shmangur mangësitë e evidentuara gjatë vendim-marrjes në periudhën e audituar.

***Vazhdimisht***

Regulloret e Brendshme të Funksionimit të shoqërisë, kanë mangësi dhe papërshtatshmëri në caktimin e detyrave të punonjësve sipas pozicioneve të punës, si në disa raste në kundërshtim me aktet ligjore të prokurimit publik në fuqi dhe në disa raste me pasoja të konfliktit të interesit. Për disa pozicione pune, nuk janë përcaktuar kriteret dhe profesioni, ***sa më sipër rekomandoj:***

**6-** Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë, të marrin masa për miratimin Rregullores së brendshme, në të cilën të implementohet ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe Udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

***Menjëherë***

**7-** Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë, të marrin masa për përmirësimin e Rregullores së brendshme, në të cilën të përcaktohen saktë struktura e shoqërisë, niveli i pagave, sipas pozicioneve të punës, nivelit arsimor dhe detyrave të secilit vend pune. .

***Menjëherë***

Sipas urdhrit të brendshëm nr.4, datë 29.02.2012, të ish Drejtorit z. [REDAKTUAR] janë ulur pagat e punonjësve në masën 10% për 23 vetë dhe për 10 punonjës sigurie në masën 5%, duke filluar nga data 1 Mars - pa afat, kjo për arsye të situatës së vështirë ekonomike. Këshilli Mbikëqyrës nuk ka vepruar, nuk ka miratuar dhe nuk ka marrë në analizë këto ndryshime, etj, veprime në kundërshtim me ligjin nr.10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” neni 2/ç “Kompetencat në caktimin e pagës”. Urdhrat e titullarit për ndryshimet në pagat e punonjësve të cilët kanë ndryshuar pozicionin e vendit të punës, si edhe procedura e ndjekur për përcaktimin e pagave punonjësve të rinj, janë kryer pa marrë miratim dhe vendim nga Këshilli Mbikëqyrës, veprime në kundërshtim me ligjin nr.10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 2/ç, “Kompetencat në caktimin e pagës” dhe VKM 318. Në përcaktimin e nivelit të pagave mungon baza ligjore dhe konstatohet se niveli i pagave për vitet 2012, 2013 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2014, është përcaktuar sipas urdhrave të drejtorit, pa marrë miratim nga këshilli mbikëqyrës, nuk ka asnjë bazë ligjore për përcaktimin e pagave sipas pozicioneve të punës, nuk ka tabelë pagash sipas klasave dhe

pozicioneve të punës, nuk ka përcaktim të kriterëve për vendin e punës me nivelin arsimor. Nivelet e pagave nuk janë miratuar nga organet kolegjiale drejtuese të shoqërive tregtare. Këshilli Mbikëqyrës, ka miratuar strukturën organizative të vitit 2013, në nivel drejtorish, vetëm si numër, por nuk ka përcaktuar nivelin e pagave dhe nivelin arsimor për çdo pozicion pune, **sa më sipër rekomandoj:**

**8-** Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë, të marrin masa që për nivelin e pagave dhe të shpërblimeve të zbatojnë kërkesat e ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, si dhe kërkesat e Kodit të Punës, duke i harmonizuar ato me kontratat e punës dhe aktet e tjera të shoqërisë.

**Menjëherë**

Nga drejtoria nuk janë azhurnuar vendimet në lidhje me caktimin e dietave të punonjësve që shkojnë me shërbim jashtë vendbanimit të tyre, **sa më sipër rekomandoj:**

**9-** Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të marrin masat e nevojshme për hartimin dhe nxjerrjen e një vendimi të ri për të përcaktuar dhe zbatuar procedura të rregullta, për shpenzimet e kryera për udhëtim e dieta brenda vendit, në përputhje me legjislacionin në fuqi të kësaj fushe.

**Menjëherë**

Nuk është hartuar e paraqitur në Agjencinë e Prokurimit Publik regjistri i parashikimit dhe realizimit të prokurimeve, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

U konstatuan veprime në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu VI pika 2/b, **sa më sipër rekomandoj:**

**10-** Administratori i shoqërisë dhe departamentet përkatëse, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e procedurave të prokurimit publik për blerje me vlera të vogla, si dhe likuidimi i shpenzimeve të bëhet me plotësimin e të gjithë dokumentacionit ligjor përkatës.

**Menjëherë**

Zërat e programit ekonomik janë planifikuar në mënyrë tejet të gabuar, shoqëria nuk ka parashikuar drejt të ardhurat që do të krijohen nga aktiviteti kryesor i saj, përpunimi i mallrave, me një nivel të ulët të realizimit të investimeve në masën 66% për vitin 2012 dhe 13% për vitin 2013, rezultate të cilat flasin për një punë të dobët të strukturave drejtuese, për realizimin e objektivave të përcaktuara, nuk ka pasur planifikim të saktë, niveli i realizimit të investimeve është shumë ulët, *veprime që ngarkojnë me përgjegjësi ish drejtorin [ ] dhe ish kryetarin e kësaj dege [ ]* Ndryshimet në programin ekonomik financiar për shtesat dhe pakësimet, nuk janë miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës dhe METE, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 08.04.2009, Kreu IV, “Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës”. Konstatohet tejkalim i fondit të pagave në masën 102%, për 6 mujorin e parë të vitit 2014, si pasojë e ristrukturimit të organikës dhe shtimit të personelit me 3 punonjës, **sa më sipër rekomandoj:**

**11-** Këshilli Mbikëqyrës, të marrë masat për të hartuar programin vjetor të veprimtarisë së tij bazuar në pikën III “Procedurat për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit mbikëqyrës”, 1 e 2 të Udhëzimit nr. 318, datë 08.04.2009 të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

***Menjëherë***

Nuk ka dokumentacion mbi përcaktimin e normativës së harxhimit të karburantit për 100 km, nuk ka program pune bashkëlidhur, në planifikimin e shpenzimeve për karburant, mungojnë përlogaritjet nga dega e programimit dhe investimeve, por është mjaftuar vetëm me vendosjen çdo vit të kufirit maksimal të blerjeve me vlera të vogla në shumën 400.000 lekë, pa TVSh, nuk ka limite të përcaktuara e miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës, nuk ka procedurë të miratuar nga Drejtimi i Shoqërisë, mbi mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit dhe llogaritjes së normativave, nuk ka punonjës të caktuar për llogaritjen e shpenzimeve të karburantit, mungojnë të dhëna për gjendjen e karburantit në fillim e në fund të muajit. Për periudhën objekt auditimi rezulton se brenda qytetit të Sarandës janë përshkuar mesatarisht 1500 km/muaj, të paargumentuara me dokumentacionin përkatës, veprime në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe Udhëzimin nr.30, të Ministrisë së Financave, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” , ***sa më sipër rekomandoj:***

**12-** Administratori i shoqërisë dhe departamentet përkatëse, të marrin masat e nevojshme për mirë administrimin e shpenzimeve për karburant, duke përcaktuar dhe plotësuar fletë shërbimet që pasqyrojnë kilometrat e përshkuara prej tyre, cilësimin e destinacionit, distancave dhe të nënshkruhen me përgjegjësi nga drejtuesi i mjetit, personat urdhërues, bazuar edhe në kilometrazhin e mjeteve në fillim dhe në fund të muajit sepse është konstatuar se vetëm brenda qytetit të Sarandës janë përshkuar rreth 1,500 km/muaj, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin nr. 30, të Ministrisë së Financave, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”.

***Menjëherë***

Rritja e debive nga 2012 në 2013 vjen si pasojë e faturimeve të vitit 2013 për periudhat nëntor dhjetor të cilat janë më shumë se në vitin 2012. Po kështu konstatohet se për 6-mujorin e parë të vitit 2014 detyrimet debitore janë në shumën 6,259,346 lekë, ***sa më sipër rekomandoj:***

**13-** Administratori i shoqërisë dhe dega e financës, të marrin masat e nevojshme për të bërë ndjekjen sistematike dhe të vazhdueshme të detyrimeve debitore, vlera e të cilave është 6,259,346 lekë.

***Vazhdimisht***

Në dokumentet e shoqërisë, bën pjesë edhe Rregullorja e Brendshme, “Për organizimin dhe funksionimin e forcës së sigurisë të anijeve dhe portit” kjo rregullore është hartuar qysh në datë 19.12.2007 dhe ka një bazë ligjore të pa përditësuar , ***sa më sipër rekomandoj:***

**14-** Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e Rregullores së Brendshme, “Për organizimin dhe funksionimin e forcës së sigurisë të anijeve dhe portit” e cila është hartuar qysh në datë 19.12.2007 dhe ka një bazë ligjore të pa përditësuar me ndryshimet në legjislacion.

### **Menjëherë**

Drejtesit e shoqërisë (sipas periudhave që ato kanë drejtuar), nuk kanë ndërmarrë hapa për futjen dhe implementimin në Rregullore të ligjit nr. 10296, të datës 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011, të Ministrit të Financave, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, për të përcaktuar qartë përgjegjësitë e nëpunësit autorizues dhe zbatues, **sa më sipër rekomandoj:**

**15-** Administratori i shoqërisë, të marrë masa për futjen dhe implementimin në rregullore të ligjit nr. 10296, të datës 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, hyrë në fuqi në 01.01.2011, ku parësore është caktimi i nëpunësit autorizues, neni 8, pika 2, si dhe atij zbatues, neni 12 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, të Ministrit të Financave, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, për të përcaktuar qartë përgjegjësitë e nëpunësit autorizues dhe zbatues.

### **Menjëherë**

Gjatë 6 muorit të I-rë të vitit 2014, si pasojë e ndryshimeve në strukturë konstatohet se, ka pasur largime të punonjësve nga puna, si edhe lëvizjeve të pozicioneve të punës së punonjësve. Nga 10 punonjës të larguar, 5 prej tyre kanë hapur padi ndaj SHA “Porti Detar”, Sarandë, për rikthimin në vendin e punës dhe janë në proces gjyqësor, **sa më sipër rekomandoj:**

**16-** Administratori i shoqërisë dhe këshilli mbikëqyrës, të marrin masat e nevojshme që ndryshimet strukturore të jenë të argumentuara, ti shërbejnë arritjes së objektivave të shoqërisë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **Vazhdimisht**

Nuk janë hartuar dhe miratuar rregullat specifike me urdhër të veçantë të titullarit, për ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë, sistemin e evidentimit, monitorimit, kontrollit dhe informimit, sipas udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, veprim i cili ngarkon me përgjegjësi ish drejtorin [REDAKTUAR], **sa më sipër rekomandoj:**

**17-** Administratori i shoqërisë, të marrë masa për të hartuar dhe miratuar rregullat specifike me urdhër të veçantë, për ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë, sistemin e evidentimit, monitorimit, kontrollit dhe informimit, sipas udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu I, pikat 5,7, dhe kreu II, pika 19.

### **Vazhdimisht.**

Nga auditimi i sipërfaqeve të dhëna me qira, rezultuan diferenca për të cilat sipas llogaritjeve rezulton dëm ekonomik në shumën **2,416,144 lekë**, nga të cilat **1,984,144 lekë**, nga ambienti me qira me objekt “klub në katin e dytë të terminalit të pasagjerëve”, **vlera prej 432,000 lekë**, nga dega e doganës Sarandë dhe **17,080 lekë**, nga kompania e ndërtimit “[REDAKTUAR]”. **Për dhënien me qira të ambienteve të SHA “Porti Detar” Sarandë, mungon dokumentacioni ligjor, i përcaktuar në VKM nr.529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë, apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. Dokumentacioni mbi**

kontratat e nënshkruara për ambientet e dhëna me qira nuk është inventarizuar, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”. Nga shoqëria, nuk është kryer monitorimi i kontratave. Drejtori i shoqërisë, nuk ka urdhëruar ngritjen e një komisioni monitorimi ose të ketë autorizuar punonjës të shoqërisë, për monitorimin e kontratave me qira të lidhura me subjektet të cilat ushtrojnë aktivitet në ambientet e shoqërisë, **sa më sipër rekomandoj:**

**18-** Administratori i shoqërisë, të marrë masat e nevojshme për plotësimin e dokumentacionit ligjor për ambientet e dhëna me qira sipas kontratave të nënshkruara me subjektet private, sipas kërkesave të përcaktuara në VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë, apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” .

**Menjëherë**

**19-** Administratori i shoqërisë, të marrë masat e nevojshme për monitorimin e kontratave për ambientet e dhëna me qira sipas kontratave të nënshkruara me subjektet private, sipas përcaktimeve në VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë, apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

**Menjëherë**

**20-** Administratori i shoqërisë, këshilli mbikëqyrës dhe dega e programim zhvillimit, të marrin masat e nevojshme për nënshkrimin e kontratave për ambientet e dhëna me qira sipas sipërfaqeve faktike, në zbatim të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë, apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

**Menjëherë**

Nga puna e paguar 21% e saj është punë efektive e kryer dhe e paguar në funksion të ngarkim shkarkimit, me objekt kryesor: “Për përpunimin e anijeve”, ndërsa 79% të ditë punëve të paguara nuk janë ditë pune efektive ku përfshihen pagesat e kryera me pagë bazë për mirëmbajtjen e ambientit të jashtëm, për nevoja të degës teknike dhe për forcën e sigorisë.

Janë kryer pagesa në shumën **476,440 lekë**, për punëtorët të cilët sipas dokumentacionit bashkëlidhur listëpagesave dhe verifikimit të kryer në vend, (procesverbal ku kanë firmosur punëtorët), kanë punuar për nevoja të degës teknike, të riparimit të vinçit në një kohë që ky vinç, për t`u riparuar dhe montuar është kontraktuar me operatorin fitues të tenderit. Ky veprim është i kundërligjshëm, këto punime janë parashikuar në kontratën e lidhur midis palëve dhe janë detyrim i palës kontraktore për t`u kryer bazuar në nenin 9 “Personeli i sipërmarrësit”. **Shuma 476,440 lekë, përbën dëm ekonomik**, i shkaktuar nga Kryetari i Degës Teknike, [REDAKTUAR] normisti [REDAKTUAR] dhe ish Kryetari i Degës së programimit dhe të investimeve, [REDAKTUAR] i cili në bazë të Rregullores së Brendëshme, neni 12, pika 7.

Pagesat e kryera me pagë bazë për forcën e sigorisë, janë në kundërshtim me të gjitha pikat e përcaktuara në Rregulloren “Për funksionimin e forcës së sigorisë portuale Sarandë”, nr.11, datë 19.12.2007. Për pagesat e kryera punonjësve të portit në kundërshtim me këtë rregullore **me efekt ekonomik negativ për shoqërinë në shumën 1,274,900 lekë.**

Pagesat e kryera pa volume pune, të pa argumentuara dhe të pa justifikuara me punë faktike në shumën **3,054,880 lekë**, e cila përbën efekt ekonomik financiar negativ për SHA “Porti Detar” Sarandë, **sa më sipër rekomandoj**:

**21-** Administratori i shoqërisë, dhe degët të marrin masa që pagesat e kryera të jenë me volume pune, të argumentuara dhe të justifikuara me punë faktike, sepse nga auditimi rezultoi se janë kryer pagesa të paargumentuara dhe të pajustificuara në shumën 3,054,880 lekë.

**Menjëherë.**

Lidhja e kontratave për **pranimin dhe përpunimin e trakteve të pasagjerëve**, me shoqëritë e transportit përkatëse dhe Agjencitë Detare sipas nenit B, pika 1, të tyre, është pa bazë ligjore pasi ato janë bazuar në Udhëzimin nr.10, datë 23.06.2008, neni 5, të MPPT, “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit, pezullimit dhe heqjes së lejeve për ushtrimin e veprimtarisë dhe lejeve të operimit në fushat e transportit detar” pasi ky udhëzim nuk ka fuqi ligjore si pasojë e daljes së ligjit të ri.

Për lidhjen e kontratave me traktet e linjës nuk është kërkuar asnjë dokumentacion nga shoqëritë që kanë lidhur kontratë, nisur nga fakti që kontratat në bazë të Udhëzimit të mësipërm, janë lidhur para dhënies së licensës. Në të gjitha rastet kontratat janë firmosur edhe nga agjentët detar e doganor, por në asnjë rast nuk ka prokurë dhe kërkesë të lëshuar nga kërkuesi. Kontratat nuk kanë të përcaktuar: adresën e shoqërisë kontraktuese, nuk ka asnjë të dhënë identifikimi për administratorin e shoqërisë, nuk jepet asnjë e dhënë e mëtejshme për identifikimin e agjencisë detare dhe doganore dhe të administratorit të saj, nuk ka asnjë nen ku të jetë përcaktuar numri i anijeve që do të operojnë me këtë shoqëri. Ky numër është përcaktuar vetëm në aneks kontratë dhe në 5 raste u konstatua se kontratorët kanë filluar aktivitetin pa u licencuar më parë. Kontratat e lidhura nuk kanë të përcaktuar në asnjë rast sanksione për likuidimin e detyrimeve në kohë, e për rrjedhojë krijohen detyrime debitoare për shoqërinë.

Kontratat e lidhura me subjektet private për vitet 2012 e 2013, dhe pjesërisht të vitit 2014, nuk janë të protokolluara, në kundërshtim me ligjin nr.9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, duke lënë shteg për abuzime.

Për vitin 2014 është lidhur kontrata me SHA “Porti Detar” Sarandë, i përfaqësuar nga Drejtori [REDAKTUAR] dhe shoqërisë [REDAKTUAR], e përfaqësuar nga Agjencia Detare [REDAKTUAR], me përfaqësues z. [REDAKTUAR] dhe për ushtrimin e këtij aktiviteti të transportit detar shoqëria “[REDAKTUAR]”, është e pa licencuar, në një kohë që janë licencuar nga agjencia doganore, e cila nuk kryen transport detar, por kryen shërbimet portuale, me licencën e lëshuar nga QKL. Pajisja nga QKL me licencë “Për transport ndërkombëtar detar të mallrave dhe njerëzve” agjentëve detar dhe jo e shoqërive që ushtrojnë aktivitetin e transportit detar, është në kundërshtim me ligjin nr.10081, datë 23.12.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

Nga krahasimi i të dhënave që disponon SHA “Porti Detar” Sarandë me Pikën e Kalimit Kufitar, Sarandë për numrin e personave që kanë hyrë dhe dalë nga territori shqiptar, rezultojnë diferenca. Këto diferenca janë të pajustificuara dhe ngarkojnë me përgjegjësi inspektorin e kalatës z. [REDAKTUAR] dhe agjentët përkatës të cilët hartojnë deklaratat për imbarkimin dhe disimbarkimin e pasagjerëve.

Kontratat e lidhura me subjektet **private për përpunimin e mallrave** për vitet 2012, 2013 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2014, nuk janë të protokolluara, në kundërshtim me ligjin nr.9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, duke lënë shteg për abuzime.

Nuk ka asnjë përcaktim në rregulloren e brendshme të SHA “Porti Detar” Sarandë për dokumentacionin që duhet të paraqitet para dhe mbas lidhjes së kontratës, si edhe për realizimin e saj. Kontratat e lidhura me agjentin detar dhe spedicioner për periudhën 2012-2013, në asnjë rast nuk kanë bazë ligjore dhe nuk kanë të përcaktuara tarifat, në asnjë rast nuk kanë prokurë për agjentët, nuk jepet asnjë e dhënë identifikimi për agjentin, nuk jepet asnjë e dhënë mbi subjektin që pret mallin, në asnjë rast nuk ka nen mbi mënyrën e pagesës dhe sanksioneve.

Lejet e përpunimit të anijeve të lëshuara nga Forca e Sigurisë, janë pa numër rendor. Ato nuk kanë asnjë të dhënë mbi kushtet e sigurisë që kanë plotësuar për t’u lejuar për të filluar përpunimi.

Lejet e shkarkimit të lëshuara nga Dega e Doganës Sarandë, janë pranuar nga Porti Detar, Sarandë, pa numër protokolli, pa përmbajtje, si dhe as se kujt i është lëshuar ky dokument. Leja e zhdoganimit është firmosur nga doganieri dhe jo nga titullari i Degës së Doganës Sarandë, **sa më sipër rekomandoj:**

**22-** Administratori i shoqërisë dhe Dega e Përpunimit, të marrin masa që për lidhjen e kontratave të përpunimit të pasagjerëve dhe të mallrave, të vendosin bazën ligjore, të kërkojnë dokumentacionin ligjor nga shoqëritë me të cilat do të lidhin kontratë.

**Menjëherë**

**23-** Administratori i shoqërisë dhe Dega e Përpunimit, të marrin masa që agjentët detar dhe doganor të të jenë të paisur me prokurë dhe kërkesë të lëshuar nga subjektet që kryejnë transportin detar të pasagjerëve për të nënshkruar kontratat përkatëse.

**Menjëherë**

**24-** Administratori i shoqërisë dhe Dega e Përpunimit, të marrin masa për hartimin e kontratave duke përcaktuar sanksione për zbatimin dhe likuidimin e detyrimeve kontraktuale.

**Menjëherë**

**25-** Administratori i shoqërisë dhe degët përkatëse, të marrin masa për protokollimin e kontratave, pasi nga auditimi rezultoi se ato janë të pa protokolluara, në kundërshtim me ligjin nr.9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”.

**Menjëherë**

**26-** Administratori i shoqërisë dhe degët përkatëse, të marrin masa që kontratat të kenë të përcaktuar adresën e shoqërisë kontraktuese, të dhëna identifikimi për administratorin e shoqërisë dhe agjencisë, përcaktimin e numrit të anijeve që do të operojnë me këtë shoqëri, pasi ky numër është përcaktuar vetëm në aneks kontratë si dhe fillimi i aktivitetit të bëhet pasi subjekti të jetë licencuar.

**Menjëherë**

**27-** Administratori i shoqërisë dhe degët përkatëse, të marrin masa që kontratat që do të lidhen me shoqëritë që merren me aktivitetin e transportit detar të pasagjerëve të jenë të licencuar, pasi nga auditimi u konstatuan raste që janë të licencuar agjencitë doganore të cilët nuk kryejnë transport detar, por kryejnë shërbimet portuale, me licencën e lëshuar nga QKL, në kundërshtim me ligjin nr. 10081, datë 23. 12.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

**Menjëherë**

**28-** Administratori i shoqërisë dhe Këshilli Mbikëqyrës, të marrin masa që në strukturën e SHA “Porti Detar” Sarandë, të ketë emërtesë për pozicionin “jurist”, për hartimin e kontratave, etj.

***Menjëherë***

**29-** Administratori i shoqërisë, Këshilli Mbikëqyrës dhe Dega e Përpunimit, të marrin masa për të përcaktuar procedurat që duhen ndjekur për të kryer rakordimet ditore me Pikën e Kalimit Kufitar, Sarandë, për numrin e hyrjeve e daljeve të pasagjerëve turistikë shqiptarë e të huaj.

***Menjëherë***

**30-** Administratori i shoqërisë, Këshilli Mbikëqyrës dhe Dega e Përpunimit të marrin masa për të përcaktuar dokumentacionin që duhet të paraqitet përpara lidhjes së kontratave të përpunimit të mallrave si dhe dokumentacionin që duhet për të vërtetuar realizimin e tyre.

***Menjëherë***

**31-** Administratori i shoqërisë, Këshilli Mbikëqyrës, Dega e Përpunimit dhe Forca e Sigurisë, të marrin masa që lejet e përpunimit të anijeve të lëshuara nga Forca e Sigurisë, të jenë me numër rendor, me të dhëna të plota bazuar në rregulloren e forcës së sigurisë, të administruara fizikisht me nr. protokolli dhe listuara elektronikisht.

***Menjëherë***

**32-** Administratori i shoqërisë, Këshilli Mbikëqyrës, Dega e Përpunimit në bashkëpunim me Degën e Doganës Sarandë, të marrin masa që lejet e shkarkimit të lëshuara nga Dega e Doganës Sarandë, të jenë sipas kërkesave të “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, kapitulli II-B, “Përpilimi, shtypja, shumëfishimi dhe evidencimi i dokumenteve”, neni 12, dalë në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”.

***Menjëherë***

Dosjet e tenderëve janë të pa inventarizuar dhe të pa arkivuar, në kundërshtim me ligjin nr.9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, për të cilën mban përgjegjësi njësia e prokurimit, ***sa më sipër rekomandoj:***

**33-** Administratori i shoqërisë, të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të procedurave të prokurimit nga llogaritja e fondit limit deri në realizimin përfundimtar të tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”.

***Menjëherë***

Nga auditimi i dy procedurave të prokurimit rezultoi se në dosje nuk disponohet asnjë dokumentacion mbi domosdoshmërinë e kryerjes së punimi, nuk ka asnjë urdhër nga titullari i AK, për përcaktimin e zyrtarëve që do të hartojnë përlllogaritjen e fondit limit, nuk ka asnjë të dhënë për mënyrën e llogaritjes së fondit limit, për preventivin e punimeve nuk disponohet asnjë skicë, vizatim e projekt, nuk ka asnjë preventiv analitik të punimeve që duhet të kryhen, nuk ka asnjë të dhënë se çfarë pjesësh do të riparohen dhe se çfarë artikuj të rinj do të blihen, çfarë parametrash specifike duhet të kenë, nuk ka asnjë të dhënë se si kanë dalë çmimet e përcaktuara për llogaritjen e fondit limit, në këtë preventiv zërat e punimeve janë në total, të pa ndara në mënyrë analitike, në kundërshtim me VKM nr 514, datë 15.8.2007, Udhëzimin nr.2, të Këshillit të Ministrave, datë 08.05.2003, ligjin nr.9643, datë 20.11.2006. Përcaktimi i pjesëmarrësve në

tender është bërë nga titullari i AK, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, për sa më sipër mban përgjegjësi titullari i AK. Nuk ka asnjë procesverbal të njësisë së hartimit të DT, për përcaktimin e pjesëmarrësve në këtë tender si dhe asnjë burim informacioni se pse janë përzgjedhur këta pjesëmarrës. Dokumentet e tenderit, pjesë e dosjes së prokurimit janë të pa nënshkruara nga anëtarët e njësisë së prokurimit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, nuk kanë bashkëlidhur projektin e zbatimit dhe specifikimet teknike. Operatori ekonomik “Mane`s” shpk, i shpallur fitues, në objektin e veprimtarisë së tij nuk ka lidhje as të përafërt me objektin e prokurimit, nuk i ka patur të gjitha dokumentet në ditën e hapjes së tenderit, gjithashtu dokumentet që vërtetojnë numrin e fuqisë punëtore kanë mospërputhje të numrit të punëtorëve. **Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se** kontraktuesi ka filluar punë pa u lidhur kontrata midis palëve, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 58. Për sa më sipër mban përgjegjësi Titullari i AK që ka lejuar fillimin e punimeve pa u lidhur dhe siguruar më parë kontrata si dhe [REDAKTUAR] me detyrë ish Kryetar i Degës së Programimit dhe Investimeve. Nga auditimi i procedurave të prokurimit të tenderit me objekt “Çmontim dhe transport elektrovinçi nga porti i qytetit në Portin e Limjonit”, i cili është jashtë periudhës së auditimit, por që ka lidhje funksionale me tenderin e mësipërm, i zhvilluar me urdhër prokurimi nr.4, nr.136, datë 18.07.2011, me fond limit 6,500,000 lekë me TVSh, dhe kontraktor “. [REDAKTUAR]” Sarandë, me vlerë të ofertës 5,285,000 lekë, rezultoi se procedurat e **kryera lënë shteg për abuzime** e konkretisht: Preventivi i punimeve është hartuar pa u bazuar në manualin e çmimeve si dhe zërat e tij janë në total, të pa specifikuar dhe të pa ndara në mënyrë analitike proceset e punës që do të kryhen, çmimet janë në total dhe jo sipas proceseve të punës që do të kryhen, në kundërshtim me: VKM nr 514, datë 15.8.2007, Udhëzimin nr.2, të Këshillit të Ministrave, datë 08.05.2003, ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

- Për kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional operatori fitues, ka paraqitur vërtetime dhe dokumente të cilat nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit. Nga KVO nuk ka asnjë dokumentacion të firmosur prej tyre, mbi rezultatet e tenderit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, Kreu V, pika 4, dhe me Udhëzimin e APP-së, “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në prokurimin me mjete elektronike”.

- Për këtë objekt është punuar edhe nga punëtorët e portit, e vërtetuar kjo edhe me procesverbal të mbajtur me punëtorët, në shumën prej **58,560 lekë**, shumë e cila **përbën dëm ekonomik, pasi** të gjithë urdhrat janë të kundërligjshëm, pasi ato janë punime të parashikuara në kontratën e lidhur midis palëve dhe janë detyrim i palës kontraktore për tu kryer, **sa më sipër rekomandoj:**

**34-** Administratori i shoqërisë, të marrë masa që të zbatohen në mënyrë korrekte në përputhje me rregullat e prokurimit publik përllogaritja e fondit limit, hartimi i preventivave, hartimin e dokumenteve të tenderit, procesverbalet e punës së komisionit, vlerësimin e operatorëve ekonomikë, lidhjen e kontratave sipas afateve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore të prokurimit publik dhe zbatimin e tyre.

#### **Vazhdimisht**

**35-** Administratori i shoqërisë dhe degët përkatëse, të analizojnë dhe të marrin masa për të mos u përsëritur mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit dhe zbatimin e kontratave, në drejtim të llogaritjes së fondit limit, në drejtim të hartimit të dokumenteve të tenderit, në drejtim të vlerësimit të dokumenteve administrative e ligjore, në drejtim të lidhjes dhe zbatimit të kontratave.

## **Menjëherë**

Dosjet e personelit nuk janë të plota, ka mangësi në dokumentacion. Po kështu, në dosjet e personelit mungon dosja e punonjësit Muharem Merko, dhe nuk ka asnjë të dhënë mbi nivelin arsimor, vjetërsinë, etj, **sa më sipër rekomandojmë:**

**36-** Administratori i shoqërisë dhe Dega e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin e dosjeve personale të punonjësve të shoqërisë, me gjithë dokumentacionin e kërkuar në bazë të legjislacionit në fuqi. .

## **Menjëherë**

SHA “Porti Detar” Sarandë, për 2 procedurat e prokurimit të kryera për çmontim dhe transport elektrovinçi, riparim dhe montim vinçit ganz, ka kaluar një periudhë kohore prej 14 muaj. Gjatë kësaj periudhe shkarkimi i anijeve është bërë me tarifa nga 100% e vlerës është ulur në 65% të vlerës sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr.17, datë 15.12.2011, kapitulli 2, tarifa nr.20. Nisur nga planifikimi jo i saktë i kryerjes së procedurave të prokurimit, efekti ekonomik negativ është 1,955,224 lekë, të ardhura më pak për SHA “Porti Detar” Sarandë.

-Është urdhëruar likuidimi i shtesës së kontratës me objekt, “Ndërtim i rrethimit të Portit të Limjonit”, me vlerë 960,000 lekë, ose 2 vjet 5 muaj më vonë nga përfundimi i kontratës bazë. Për këtë volum punimesh, nuk ka asnjë dokumentacion sipas kërkesave të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 12, si dhe me VKM nr.444, datë 05.09.1994 “Për tarifat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudit të veprave të ndërtimit. Likuidimi i shumës prej 960,000 lekë, pa zbatuar kërkesat e bazës ligjore të mësipërme përbën dëm ekonomik për shoqërinë, **sa më sipër rekomandojmë::**

**37-** Administratori i shoqërisë dhe Dega e Programim Zhvillimit, të marrin masa që të planifikojë saktë afatet kohore për kryerjen e investimeve, sepse nga auditimi rezultoi se për 2 procedurat e prokurimit të kryera për çmontim dhe montim vinçit ganz, ka kaluar një periudhë kohore prej 14 muaj me efekt ekonomik negativ në shumën 1,955,224 lekë.

## **Vazhdimisht**

### **B. MASA PËR SHPËRBLIMIN E DËMIT**

**1.** Administratori i shoqërisë, të marrë masa duke ndjekur rrugët ligjore për arkëtimin e shumës **1,234,464 lekë**, nga subjektet ■■■■ dhe ■■■■ detyrim për qira të pashlyer, sipas vendimit të Gjykatës së Lartë nr. 639, datë 28.03.2013, për objektin “klub tregtimi në katin e dytë të terminalit të pasagjerëve”.

## **Menjëherë**

**2.** Administratori i shoqërisë, të marrë masa duke ndjekur rrugët ligjore për arkëtimin e shumës **749,680 lekë**, nga subjektet ■■■■ dhe ■■■■ detyrim për qira për sipërfaqen në përdorim më tepër nga sa është përcaktuar në kontratë, për objektin “klub tregtimi në katin e dytë të terminalit të pasagjerëve”.

### ***Menjëherë***

3. Administratori i shoqërisë, të marrë masa duke ndjekur rrugët ligjore për arkëtimin e shumës **432,000 lekë**, nga Dega e Doganës, Sarandë, detyrim për qira për sipërfaqen në përdorim më tepër nga sa është përcaktuar në kontratë, për objektin “Zyra në portin e Limionit”.

### ***Menjëherë***

4. Administratori i shoqërisë, të marrë masa duke ndjekur rrugët ligjore për arkëtimin e shumës **17,080 lekë**, nga kompania e ndërtimit “█████”, detyrim për qira për sipërfaqen në përdorim më tepër nga sa është përcaktuar në kontratë, për objektin “zyra në godinën e administratës”.

### ***Menjëherë***

5. Administratori i shoqërisë, të marrë masa administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në **shumën 535,000 lekë, dëm ekonomik** i shkaktuar nga Kryetari i Degës Teknike, .█████ ish drejtori █████ normisti █████ dhe ish Kryetari i Degës së programimit dhe të investimeve, █████ për pagesat e kryera punëtorëve të portit, punë e cila sipas kontratave duhej kryer nga kontraktorët “█████” dhe “█████”.

### ***Menjëherë***

6. Administratori i shoqërisë të marrë masa administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në **shumën 960,000 lekë, dëm ekonomik** i shkaktuar nga ish Drejtori .█████ dhe ish Kryetari i Degës së Programim Investimeve, z. █████ për likuidimin e shtesës së kontratës me objekt, “Ndërtim i rrethimit të Portit të Limionit”, me 27 muaj më vonë nga përfundimi i kontratës bazë, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 12, si dhe VKM nr. 444, datë 05.09.1994 “Për tarifatat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudit të veprave të ndërtimit.

### ***Menjëherë***

## **C. MASA DISIPLINORE**

I. I lihet detyrë Këshillit Mbikëqyrës, të marrë masën “**Largim nga puna**”, për z. █████ me detyrë Drejtor i “Portit Detar” Sha, Sarandë, për shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për arsye se:

- nuk ka ndërmarrë hapa për futjen dhe implementimin e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, hyrë në fuqi në 01.01.2011, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit, të Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- ka dhënë urdhra për ndryshimet dhe përcaktimin në pagat e punonjësve pa marrë miratim nga Këshillit Mbikëqyrës, në kundërshtim me ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 2/ç, “Kompetencat në caktimin e pagës”.
- ka lejuar tejkalimin e numrit të punonjësve për 6 mujorin e I-rë të vitit 2014.
- nuk ka përcaktuar rregullat, procedurat dhe limitet për shpenzimet e karburantit, mbi mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit dhe llogaritjen e normativave.
- ka miratuar pagesat e punëtorëve të ngarkim shkarkimit për punë për forcën e sigurisë, në kundërshtim me pikat e përcaktuara në Rregulloren “Për funksionimin e forcës së sigurisë

portuale Sarandë”, nr.11, datë 19.12.2007, duke shkaktuar efekt ekonomik negativ në shumën **190,320 lekë**.

-ka miratuar dokumentacion për kryerjen e pagesave të punonjësve si raportet e punës, koha e normuar, listë pagesat, etj, pa pasqyruar volumet dhe zërat e punëve të kryera.

-ka nënshkruar kontratë qiraje me Shoqërinë e ndërtimit [REDAKTUAR], duke përcaktuar në “Detyrimet e qiramarrësit”, se “Detyrimet për harxhimin e energjisë dhe të ujit janë brenda vlerës së qirasë”, në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.06.2011, duke sjellë efekt negativ financiar të pa llogaritur.

-ka nënshkruar kontratë qiraje pa u kryer garancia e saj, në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.06.2011, Kreu II, pika 14, “Procedurat e dhënies me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore”.

-nuk ka vepruar për zbatimin e vendimit nr. 315, datë 28.09.2010, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, për arkëtimin e shumës **prej 1,234,464 lekë**, për qira të papaguar nga subjekti qiramarrës [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për objektin “klub pranë terminalit të pasagjerëve”.

-ka lidhur kontrata për pranimin dhe përpunimin e trakteve, me bazë juridike të shfuqizuar.

-ka lidhur kontrata me trakte e linjës pa kërkuar asnjë dokumentacion nga shoqëritë e transportit detar si edhe pa përcaktuar në asnjë rast sanksione për likuidimin e detyrimeve në kohë, duke sjellë debitorë në rritje.

-nuk ka ushtruar funksionin e tij për protokollimin e kontratave të lidhura me subjektet private, duke lënë shteg për abuzim, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”.

-ka lidhur kontratat pa përcaktuar elementet bazë të saj, adresë të shoqërisë kontraktuese, të dhëna identifikimi për agjencinë detare, për administratorin, numrin e anijeve që do të operojnë me këtë shoqëri, etj.

-ka lejuar ushtrimin e aktivitetit të shoqërive që kryejnë aktivitetin e transportit të pasagjerëve pa u licencuar më parë.

-nuk ka zbatuar kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu VI , “Zhvillimi i procedurës së kërkesës për propozime, prokurim me vlerë të vogël, shërbimet e konsulencës, konkursi i projektimit”, pika 2, “Prokurim me vlerë të vogël” si dhe Udhëzimet e APP-së, nr. 1, datë 01.02.2013, nr. 2, datë 28.03.2013, dhe nr.6, datë 03.09.2013, “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”.

**II-** Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar kërkoj nga Drejtori i Shoqërisë, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore **“Larqim nga puna”**, për:

**1. [REDAKTUAR] me detyrë normist, inspektor kalate, për arsye se:**

-ka hartuar dokumentacion për kryerjen e pagesave të punonjësve si raportet e punës, koha e normuar, listë pagesat, etj, pa pasqyruar volumet dhe zërat e punëve të kryera.

-ka hartuar listë pagesat e punëtorëve të ngarkim shkarkimit për çmontimin, montimin dhe riparimin e vinçit në një kohë që kryerja e punimeve është kontraktuar e likuiduar me operatorit fitues të tenderit, duke shkaktuar **dëm ekonomik në shumën 535,000 lekë**, për SHA “Porti Detar” Sarandë.

-ka hartuar listë pagesat e punëtorëve të ngarkim shkarkimit për punë për forcën e sigurisë, në kundërshtim me pikat e përcaktuara në Rregulloren “Për funksionimin e forcës së sigurisë

portuale Sarandë”, nr.11, datë 19.12.2007, duke shkaktuar efekt ekonomik negativ në shumën **1,274,900 lekë**.

- nuk ka evidentuar saktë sipas datave hyrjet - daljet e pasagjerëve turistikë shqiptarë dhe të huaj shoqëruar me diferenca të pajustificuara numrin e tyre krahasuar me listat e pikës së kalimit kufitar, duke lënë shteg për abuzime.

## **2. [REDAKTUAR] ish kryetar i Degës Teknike, për arsye se:**

-ka urdhëruar kryerjen e pagesave të punëtorëve të ngarkim shkarkimit për riparimin e vinçit në një kohë që ky vinç, për çmontuar, montuar dhe riparuar është kontraktuar e likuiduar me operatorin fitues të tenderit, duke shkaktuar **dëm ekonomik në shumën 535,000 lekë**, për SHA “Porti Detar” Sarandë.

-në tenderët me objekt “Riparim dhe montim i vinçit ganz për shërbime portuale” me fond limit 5,040,000 lekë dhe “Çmontim dhe transport elektrovinçi nga porti i qytetit në Portin e Limjonit” me fond limit 5,416,000 lekë, nuk ka hartuar asnjë skicë, vizatim e projekt për montimin e vinçit, nuk ka hartuar preventiv analitik të punimeve që duhet të kryhen, nuk ka paraqitur të dhëna mbi pjesët që do të riparohen ose artikuj të rinj që do të blihen, nuk ka hartuar specifikimet teknike, nuk ka argumentuar llogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.8.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pikat 2, 3, 9, dhe 11, Udhëzimin nr. 2, të Këshillit të Ministrave, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” dhe ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”.

-nuk ka hartuar e mbajtur procesverbalet e punës së komisionit të vlerësimit të ofertave për të pasqyruar ofertat ekonomike të pjesëmarrësve në tender, të dhëna nëse janë bërë rillogaritje për gabime aritmetikore, oferta anomalisht të ulëta, etj, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V “Zhvillimi i procedurave”, pika 4, “Hapja dhe vlerësimi i ofertave”, nënpika “i”.

-ka shpallur fitues operatorët ekonomik “[REDAKTUAR]” dhe “[REDAKTUAR]” në tenderët me objekt “Riparim dhe montim i vinçit ganz për shërbime portuale” me fond limit 5,040,000 lekë dhe “Zmontim dhe transport elektrovinçi nga porti i qytetit në Portin e Limjonit” me fond limit 5,416,000 lekë, pa plotësuar kriteret e kualifikimit të kërkuara në dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga autoriteti kontraktor, në kundërshtim me aktet ligjore të prokurimit publik.

-nuk ka zbatuar kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu VI , “Zhvillimi i procedurës së kërkesës për propozime, prokurim me vlerë të vogël, shërbimet e konsulencës, konkursi i projektimit”, pika 2, “Prokurim me vlerë të vogël” si dhe Udhëzimet e APP-së, nr. 1, datë 01.02.2013, nr. 2, datë 28.03.2013, dhe nr.6, datë 03.09.2013, “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”.

## **3. [REDAKTUAR] me detyrë sekretare arkiviste, në cilësinë e antarit të njësisë prokurimit.**

-nuk ka inventarizuar dhe arkivuar dosjet e tenderave, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”.

-nuk ka argumentuar llogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu II, “Rregullat e përgjithshme të prokurimit”, pika 2, “Llogaritja e vlerës së kontratës”, pika “c”.

-nuk kanë hartuar procesverbalet për përcaktimin e pjesëmarrësve në tender, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu IV, pika 1, “Kërkesa për propozime”, nënpika “c”.

-nuk ka nënshkruar Dokumentet e tenderit, pjesë e dosjes së prokurimit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu V, zhvillimi i procedurave, pika 2 “Hartimi i dokumenteve të tenderit”.

-nuk ka plotësuar dokumentet e tenderit me projektin e zbatimit dhe specifikimet teknike.

-nuk ka zbatuar kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu VI , “Zhvillimi i procedurës së kërkesës për propozime, prokurim me vlerë të vogël, shërbimet e konsulencës, konkursi i projektimit”, pika 2, “Prokurim me vlerë të vogël” si dhe Udhëzimet e APP-së, nr. 1, datë 01.02.2013, nr. 2, datë 28.03.2013, dhe nr.6, datë 03.09.2013, “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”.

- nuk ka hartuar e paraqitur në Agjencinë e Prokurimit Publik regjistrin e parashikimit të prokurimeve, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

#### **D. KALLËZIM PENAL**

Bazuar në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurave Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 281, është kërkuar fillimin e procedurave penale për shpërdorim të detyrës për 4 (katër) persona.

#### ***Shënim:***

Do të rekomandohej masë disiplinore, për z. [REDAKTUAR] ish Drejtor i “Portit Detar” Sha, Sarandë, [REDAKTUAR] ish Kryetar i Degës së Programim Investimeve, Shqiponja Pirro në cilësinë e anëtares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, [REDAKTUAR] në cilësinë e juristit të Njesisë së prokurimit, [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të Njesisë së prokurimit, për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, por meqenëse këta persona janë larguar nga detyra që kanë mbajtur për periudhën janar 2012 - qershor 2014, në “Portin Detar” Sha, Sarandë, masa disiplinore konsiderohet e ezauruar.

Në vijim do të njoftohet Drejtoria e Administratës Publike për personat e lartpërmendur

*Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Lolita Baholli, Mimoza Bedini, Enida Mata, , më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.*

#### **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**